

Qendra e Botimeve për Diasporën shpërndan paketën e teksteve shkollore falas

Për herë të parë që nga krijimi i saj në janar të këtij viti, ka përgatitur dhe po shpërndan paketën e teksteve shkollore për mësimdhënie në Diasporë. Rreth 11 000 tekste të gjuhës shqipe do t'u shpërndahen nxënësve dhe mësuesve shqiptarë, që gjenden jashtë trojeve shqiptare. Të gjitha tekstet janë falas dhe tërheqja e tyre do të bëhet në ambasadat shqiptare të vendeve përkatëse, sipas kërkesës së këtyre të fundit.



Ministri takohet me studentët e projektit “Rrjetëzimi i Rinisë shqiptaro-gjermane përmes kulturave”



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko u takua me një grup të rinjsh nga Gjermania të cilët vizituan Shqipërinë për t'u njohur më tepër me historinë dhe kulturën shqiptare në kuadër të projektit “Rrjetëzimi i Rinisë shqiptaro-gjermane përmes kulturave”. Grupi i përbërë nga të rinj shqiptar dhe gjermanë u njoh nga afër me punën e Ministrit të Shtetit për Diasporën, politikat dhe projektet e realizuara dhe ato në zhvillim. Gjatë bashkëbisedimit ministri Majko u shpreh se “Çdo i ri në Diasporë duhet të njoh prejardhjen familjare, historinë e vendit të origjinës, në mënyrë që të ruhet identiteti kombëtar”.

Njohja e patentave shqiptare në Itali



Patentat shqiptare njihen nga shteti italian. Drejtoria e Shërbimeve të Transportit Rrugor në Tiranë ka bërë të ditur se duke filluar nga 8 shtatori 2019 patentat shqiptare të lëshuara prej datës 24 janar 2017 do të njihen edhe në shtetin italian. Njohja dhe konvertimi i patentave shqiptare në Itali është rezultat i një pune të organizuar dhe të drejtuar nga Koordinatori Shtetëror i Patentave, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Artan Shkreli me institucionet italiane, një bashkëpunim ky i arritur në kuadër të marrëveshjes së përbashkët mes qeverive të të dyja vendeve.

Sondazhi i Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Me qëllim analizimin e karakteristikave demografike të Diasporës me qëllim nxitjen e kontakteve midis anëtarëve të Diasporës dhe shqiptarëve, mundësitë e të bërit biznes në vendin e origjinës, evidentimin rrjetit produktiv në Shqipëri, duke ofruar mundësi bashkëpunimi në e mekanizmave në funksion të Diasporës dhe kontributin e saj në hapjen dhe zhvillimin e bizneseve të reja. Ky pyetësor realizohet në zhvillimin socio-ekonomik të vendit, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e kuadër të studimit “Infrastruktura e Biznesit dhe Përfshirja e Diasporës po zhvillon një sondazh. Duke plotësuar një pyetësor të Diasporës” dhe informacioni i grumbulluar do të trajtohet në mënyrë hartuar posaçërisht për këtë studim, ju mund të kontribuoni në krijimin e konfidencialit për realizimin e qëllimit të studimit. një databazë lidhur me karakteristikat e emigrantëve shqiptarë në botë,



KKD, Mark Gjonaj në intervistë për “Zërin e Amerikës” flet për rëndësinë e Diasporës



Anëtari i Këshillit Bashkiak të Nju Jorkut dhe aktivisti shqiptar në SHBA, Mark Gjonaj në një intervistë për “Zërin e Amerikës” flet për rëndësinë e Diasporës. “Pasuria më e madhe e Shqipërisë janë shqiptarët, sidomos kur kemi më shumë shqiptarë jashtë sesa brenda kufijëve. Kjo është një pasuri e vertetë, e prekshme”, tha ai për VOA. Sipas anëtarit të KKD, Diaspora ka potencial për të qenë negociatorja që mund të vendosë ekuilibrat në realitetin politik të Shqipërisë dhe Kosovës.

KKD, vepra e Gazmend Kapllanit kompozohet nga Cheryl Frances-Hoad



Kompozitorja e famshme britanike, Cheryl Frances-Hoad, ka kompozuar një pjesë të re (titulluar “Tales of the Invisible”), të cilën do ta ekzekutojë me Kuintetin e saj të Klarinetave, bazuar në prologun e romanit “Ditar i Shkurtër Kufijsh” të shkrimtarit shqiptar Gazmend Kapllani. Romani është përkthyer në shumë gjuhë dhe është përshtatur për skenë teatri në Danimarkë, Greqi dhe Kili.